VENDIM
Nr. 7, datë 16.1.2023

MBI DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 167, DATË 28.6.2022, "MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË 'SALILLARI ENERGY TRADE' SHPK NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar; nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë; si dhe nenit 15, të rregullores "Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 16.1.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 94 prot., datë 12.1.2023, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, "Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 167, datë 28.6.2022 'Mbi licencimin e shoqërisë 'Salillari Energy Trade' sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, i ndryshuar",

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 167, datë 28.6.2022, të ndryshuar me vendimin e Bordit nr. 209, datë 17.8.2022, ka vendosur:

1. Të licencojë shoqërinë "Salillari Energy Trade" sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.
2. Përpara fillimit të operimit të veprimtarisë së licencuar, shoqëria të informojë ERE-n mbi implementimin konkret të sistemit IT.
3. Shfuqizuar.
4. Shoqëria të depozitojë në ERE kontratën e rinovuar për disponimin e zyrave, brenda datës 1.3.2023.
5. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE.

- ERE ka njoftuar shoqërinë për vendimin e mësipërm me shkresën nr. 469/8 prot., datë 30.6.2022.

- Me dokumentacionin e depozituar me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 469/10 prot., datë 10.10.2022, nr. 469/12 prot., datë 30.11.2022, dhe nr. 469/14 prot., datë 6.1.2023, shoqëria ka plotësuar kushtet e vendosura në pikën 2 dhe pikën 4, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 167/2022, i ndryshuar, ndaj si të tilla këto kushte vlerësohet të shfuqizohen.

- Duke qenë se me shfuqizimin e pikave 2 dhe 4, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 167/2022, i ndryshuar, dhe me plotësimin e të gjitha kushteve të këtij vendimi nuk gjen më zbatim as pika 5 e këtij vendimi, vlerësohet edhe shfuqizimi i saj.

- Në nenin 113, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", është parashikuar mundësia e shfuqizimit të plotë apo të pjesshëm të një akti, me nismën e vetë organit që e ka nxjerrë, duke përcaktuar dhe formën ligjore të këtij ndryshimi të aktit, e cila duhet të bëhet me një akt të ri me shkrim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të shfuqizojë pikën 2, pikën 4 dhe pikën 5, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 167, datë 28.6.2022, "Mbi licencimin e shoqërisë 'Salillari Energy Trade' sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike".
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti